



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDËTËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDËTIT PUBLIK

BULETINI MUJOR I SEMUNDSHMERISE INFEKTIVE (Pasqyra 14 Sh)

SEKTORI I EPIDEMIOLOGJISE

MAJ, 2018

Buletini mujor i sëmundshmërisë infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Epidemiologjisë, Instituti i Shëndetit Publik. Ky buletin mujor bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh nga DRSHP-te dhe DSHP-te. Ai plotësohet në pasqyrën në formatin EXCEL dhe dërgohet me postë elektronike dhe me poste zyrtare në DEKSI, Instituti i Shëndetit Publik, brenda datës 10 të çdo muaji. Te dhënat e agreguara të pasqyrës 14 sh për muajin Maj janë të dhënat e raportuara nga te 36 rrethet e vendit.

1. Semundjet diarreike

Sëmundjet diarreike, gjate muajit Maj 2018 zënë 36.1% të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me ane të Pasqyrës 14 sh dhe paraqesin një incidence 214.88/100.000 banorë. Dihet që periudha e muajve të nxehte të vitit mbart me vete frekuencën me të larte të episodeve diarreike dhe që në muajin maj vihet re një tendence në rritje të sëmundjeve diarreike. Rrethi i Shkodrës mban peshën kryesore të incidencës së Salmonelozes jotifoide dhe Shigelozes për muajin Maj 2018 në nivel kombëtar përkatësisht me incidence 2.89/10.000 banorë dhe 2.05 /10.000 banorë. Vlen të përmendet prejka e moshave femnore përkatësisht < 1 vjeç dhe 1-4 vjeç. Duke ju referuar raportimeve të toksikofeksioneve alimentare gjate muajit maj 2018 në nivel kombëtar incidenca është 7.18/100.000 banorë. Rrethet Berat, Bulqizë, Kavajë dhe Kukës mbajnë peshën kryesore në raportimin e toksikofeksioneve alimentare. Te gjitha rastet janë sporadike, nuk kanë patur lidhje epidemiologjike me njeri tjetrin dhe nuk kanë qene pjese e ndonjë shpërthimi. Incidenca e gastroenteriteve të paspecifikuara për muajin Maj 2018 në nivel kombëtar është 204.88/100.000 banorë. Gastroenteritet e paspecifikuar janë të shpërndara në të gjitha rrethet e vendit.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike në Maj 2018 (Incidenca raste/100.000 banorë)


	Raste, Maj 2018	Incidenca Maj 2018 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	0	0
Salmoneloza	53	1.89
Shigeloze (Disenteri bacilare)	40	1.43
Dizenteri amebike	0	0
Toksikofeksione alimentare	201	7.18
Gastroenterite (etiologji e panjohur)	5723	204.38
Semundje diarreike në total	6017	214.88

2. Semundjet e EPI

2.1.Fruthi

Gjate muajit Maj 2018 ne kuadrin e vazhdimësisë se epidemisë se fruthit janë konfirmuar me IgM pozitiv 286 raste nga 552 raste qe janë dyshuar ne total. Rastet janë konfirmuar ne Laboratorin e Virologjisë, ISHP.

Grafiku 1. Kurba epidemike e rasteve te dyshuara për fruth sipas datës se fillimit te rashit, Maj 2018



Rastet i përkasin kryesisht moshës pediatrike (<1 vjeç) moshe qe sipas kalendarit te vaksinimit nuk e ka kryer dozën e pare te FRP. Peshën kryesore sipas shpërndarjes gjeografike te rasteve te dyshuara dhe te konfirmuara me fruth e mban Tirana, Lezha, Kukësi dhe Durrësi.

2.2.Tuberkulozi pulmonar

Gjate muajit Maj 2018 janë raportuar 22 raste me Tuberkuloz pulmonar me ane te Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh nga DRSHP-te dhe DSHP-te. Vihet re nga te dhënat e ardhura ne ISHP qe peshën me te madhe te rasteve e mban Tirana (7 raste), Lushnjë (5 raste), Bulqizë (2 raste). Grupmosha me e prekur është 15-65+ vjeç. Nga 22 raste te suspektuara 13 janë te konfirmuar me Tuberkuloz pulmonar.

3. Zoonozat

Ne nivel vendi incidenca e Brucelozës është 0.36/100.000 banore. Rastet për muajin Maj 2018 janë raportuar nga rrethet Elbasan, Gjirokastrë, Kuçovë, Librazhd, Lushnjë, Pogradec, Sarandë, Shkodër dhe Tepelene. Gjate muajit maj ne pasqyrën 14 sh është raportuar një rast i konfirmuar me Leishmanie viscerale nga rrethi i Elbasani i grupmohës 1-4 vjeç. Gjate muajit maj është raportuar një rast suspekt Leptospiroze i grupmohës 55-59 vjeç nga rrethi i Durrësit.


Tabela 2: Frekuenca dhe incidencat e sëmundjeve Zoonotike ne Maj 2018 (Incidenca raste/100.000 banore)

	Raste, Maj 2018	Incidenca Maj 2018 (raste/100.000 banore)
Antraks (Plasje)	0	0
Brucelozë	10	0.36
Leptospirozë	1	0.04
Leishmaniaza viscerale	1	0.04
Leishmaniaza kutane	0	0

4. Hepatitet virale

Ne raportimin mujor te semundshmerise infektive gjate muajit maj 2018 janë raportuar ne total 19 raste me hepatite virale akute (Incidenca 0.68/100.000 banore) nga te cilat 6 raste janë Hepatite virale te paspecifikuar dhe 8 raste me Hepatit viral akut B dhe katër raste hepatit viral as A as B. Incidencat e rasteve me hepatit viral akut paraqiten ne grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 2. Incidencat e rasteve me Hepatite virale akute, Maj 2018



Ne lidhje me HBV, 8 rastet i përkasin grupmoshave: 35-34 vjeç (1 rast), 40-44 vjeç (3 raste), 55-59 vjeç (1 rast), dhe grupmoshës 65 + vjeç (3 raste). Katër raste janë nga rrethi Tirane.

5. Meningoencefalite

Gjate muajit Maj 2018 janë raportuar ne total 2 raste me meningoencefalite përkatësisht: 1 rast me meningit bakterial meningokoksik i suspektuar nga rrethi i Fierit dhe një rast me meningit bakterial jo-meningokoksik i konfirmuar nga Durrësi. Te dy rastet janë te grupmoshës 1-4 vjeç.

Hartoi: **Departamenti i Kontrollit te Sëmundjeve Infektive, Sektori i Epidemiologjisë.**

Silvia Bino, Eugena Tomini, Artan Simaku, Adela Vasili, Luljeta Alla, Elona Kureta, Rovena Daja, Marjeta Dervishi.

Editoi: Rovena Daja

INSTITUTI I
SHENDETIT PUBLIK

DEKSI